



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 01/242  
Datë: 09.01.2025

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 12 paragrafit 3. të Ligjit Nr.08/L-137 për Pyjet, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 janar 2025, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet dhënia në shfrytëzim e parcelës dhe objektit Nr.2440, ZK Stankovc, Komuna e Gillogocit në interes publik për trajtimin e nënprodukteve shtazore, për nevojat e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, konkretisht Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.
2. Funksionalizimi dhe operimi i objektit nga pika 1. e këtij vendimi, do të mundësojë grumbullimin dhe kategorizimin e nënprodukteve shtazore, duke garantuar konceptin e integruar të shëndetit publik (njeri-kafshë-bimë), me qëllim të fundit mbrojtjen e mjedisit.
3. Për shfrytëzimin e parcelës dhe objektit nga pika 1. e këtij vendimi, është e obligueshme pagesa e qirasë.
4. Obligohet Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 02/242  
Datë: 09.01.2025

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 janar 2025, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet Programi për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative 2025-2028 dhe Plani i Veprimit 2025-2026.
2. Struktura përgjegjëse për planifikim, koordinim të zbatimit, monitorim dhe raportim të procesit të barrës administrative caktohet Zyra për Planifikim Strategjik në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.
3. Koordinator i Procesit të Barrës Administrative caktohet Kushtrim Canolli, Zyrtar i Lartë për Planifikim të Politikave në Zyrën për Planifikim Strategjik në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.
4. Obligohen të gjitha institucionet të zbatojnë dhe të mbështesin zbatimin e Programit për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative 2025-2028 dhe Planit të Veprimit 2025-2026.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 03/242  
Datë: 09.01.2025

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 janar 2025, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Programi i Pronësisë Industriale 2025-2027.
2. Obligohet Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për zbatimin e Programit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 04/242  
Datë: 09.01.2025

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 janar 2025, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Plani i Veprimit 2025-2027 për zbatimin e Strategjisë së Reformës së Administratës Publike 2022-2027.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera kompetente për zbatim e Planit nga pika 1. të këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë